

**VENDIM**  
**Nr. 90, datë 14.2.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 383, DATË 19.5.2010,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË  
SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KOMPENSIMIT NË VLERË PËR PRONARËT E  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,  
QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 37, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, dhe të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 383, datë 19.5.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “d”, e pikës 6, shfuqizohet.
2. Kudo në tekstin e vendimit, emërtimi “Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” zëvendësohet me “Agjencia e Trajtimit të Pronave”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**